



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 11
03.09.2013

NR. VENDIMI 8
04.09.2013

V E N Ë I M

“MBI ZGJATJEN E AFATIT TE SEKUESTRIMIT TE PASURISE “

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga :

Gjyqtare : Nertina KOSOVA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Blerina Sukaj** sot, ditën e mërkurë, më dt.**04.09.2013, ora 12.30**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqësore kerkesen penale nr 11 Regjistri, me:

KERKUES: Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda - Tirane, Perfaqesuar nga Prokurori Edvin Kondili.

KUNDËR: Shtetasit nen hetim: D.L., i biri i V.dhe I D., i dtl xxx, lindur ne xxx dhe banues ne xxx, me adresë Rr. xxx, Pall.xxx Shk. X, Ap.x, Tirane.

OBJEKTI: **Zgjatje e afatit te sekuestrimit te pasurise.**

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar ne prani te prokurorit Edvin Kondili qe kërkoi pranimin e kërkesës:”Zgjatjen me 3(tre) muaj te afatit te sekuestros per pasurite e shtetasit D.L. vendosur me vendimin Nr

xx date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane''

Gjykata si mori në shqyrtim aktet e provat e paraqitura mbi mbeshtetjen e pretendimeve te prokurorise;

VËREN SE:

Me date xxx ne sekretarine e kesaj Gjykate është depozituar per gjykim kërkesa penale e Prokurorisë prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me objektin lartpërmendur, mbi vendimin nr xx date xxx te kesaj Gjykate, qe lidhet me procedimin pasuror te nisur ndaj pasurive te luajtshme te shtetasit D.L., ne baze te ligjit 10192 date 03.12.2009 "Per parandalimin dhe goditjen e krimit te organizuar dhe trafikimit nepermejte masave parandaluese kunder pasurisë".

Rezulton se Prokuroria per Krime te Renda Tirane ne funksion te procedimit penal nr. xx te regjistruar me date xxx, kunder te pandehurve: D.L., O.T. dhe A.C. te cilet jane gjykuar, e ne funksion te ketij procedimi nga hetimi i prokurorise per krime te renda Tirane ka rezultuar nder te tjera se shtetasi D.L. disponon disa llogari bankare dhe per kete arsye prokuroria për Krime të Rënda - Tiranë më datë xxx, në bazë të materialeve të disponuara më date xxx, ka regjistruar procedimin pasuror Nr.xx, per shkakun se ky shtetas është dyshuar se disponon pasuri te cilat nuk justifikohen me ndonje aktivitet te ligjshem te tij, ndaj kane filluar dhe proceduren e hetimit pasuror, ndaj personit te sipercituar.

Me vendimin nr xx date xxx kjo Gjykate ka vendosur:

" Sekuestrimin e pasurisë prane Bankes Kombetare te xxx xxx dhe me konkretisht :

Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx leke. Llogaria me nr. Xxx

ne shumen xxx USD Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro

Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro.

Shuma prej xxx euro dhe xxx lekesh.

Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor, xxx.

Per Administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet z. K.Xh., i cili eshte administrator prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

*Urdherohet sekretaria Gjyqesore e kesaj Gjykate te dergoje menjehere **kopje te ketij vendimi ne Institucionet e siperme.**"*

Ky vendim, i cili ka marre forme te prere me vendimin Nr xx datë xxx të të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, sipas të cilit është vendosur:
"Lënien në fuqi të vendimit nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për

Krime të Rënda Tiranë'', i cili është ekzekutuar duke u zbatuar ky vendim, më datë 07.03.2013.

Sipas akuzës, nga ana e mbrojtjes se shtetasit D.L., pas venies ne dijani te vendimit lartpërmendur, janë paraqitur akte dhe dokumente shkresore me qëllim justifikimin e burimeve të shumave monetare te sekuestruara, nga te cilat provohen nje pjese e te ardhurave te shtetasit D.L. e familjareve te tij, por jo shpenzimet e kryera nga ky shtetas, nder te tjera dhe shpenzimet per blerje te nje banese sikunder ajo e evidentuar ne xxx e prenotuar nga shtetasi V.L. prane firmes ‘xxx’ ne vleren xxx euro me date xxx, dhe konsiston dhe nje veprim juridik, sipas akuzës i dyshimte, me shtetasen A.D. apo blerje automjetesh dhe per kete arsye nga prokurori kerkohet kohe me teper me qellim evidentimin e sakte mbi disponimin e shumave te sekuestruara me vendimin nr xx date xxx te kesaj Gjykate. Akuza argumenton se mbi bazen e akteve te paraqitura eshte e domosdoshme te kryhen veprime te tjera shtese per te verifikuar balancen ndemjet te ardhurave dhe shpenzimeve te shtetasit D.L. dhe meqenese ky afat I zbatimit te sekuestros mbaron me date xxx bazuar ne nenin 12 pika 2; 3 e 5 te ligjit Nr 10192, ky afat duhet te zgjatet per nje periudhe 3(tre) mujore.

Mbi kete baze, provohet se ne date 07/03/2013, mbi aktet e paraqitura nga Prokuroria për Krime të Rënda - Tiranë, ky vendim eshte zbatuar pikerisht ne kete date si dhe ne referim te nenit 148 te K.Pr.Civile :

'' Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit'' pra duke patur parasysh se ne piken 5 te ligjit 10192 datë 03.12.2009 percaktohet se ***‘prokurori jo me vone se 5 dite perpara mbarimit te afatit kohor te mases se sekuestrimit te parashikuar ne piken 2 e 3 te nenit 12 te ligjit, mund te paraqesë kërkesë per konfiskimin e pasurise ose zgjatjen e afatit te masës së sekuestros. Ne rast te kerkeses për konfiskim masa e sekuestrimit zgjat deri ne perfundimin e gjykimit per konfiskimin e pasurise’’***

Në rastin konkret prokurori nuk ka paraqitur kerkesën per konfiskim te pasurise por zgjatje te afatit te mases se sekuestros dhe eshte brenda afatit ligjor, pasi'' ***dita e fundit e këtij(jo me vone se 5 dite) afati i parashikuar nga neni 12 pika 2 i takon te jete 07.09.2013 i takon në ditë pushimi(shtunë), afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit pra në datë xxx***, ndaj në këto kushte gjykata cmon se kërkesa është paraqitur sipas afatit te parashikuar ne piken 5 të nenit 12 të ligjit 10192 date 03.12.2009.

Gjykata ne referim te nenit 148 te K.Pr.Civile cmon se kjo kerkesese eshte

paraqitur ne perputhje me afatin ligjor, ndaj vijon me shqyrtimin e objektit te kesaj kerkese ate te zgjatjes se afatit te masës së sekuestros, vendosur me vendimin nr xx date xxx mbi procedimin pasuror në ngarkim të shtetasit D.L.

Në kushtet kur nga prokuroria pretendohet se i hetuari D.L., ne baze te nenit 3/1 germa “ç” është subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, e duke qenë në të njëjten pozitë, duke kërkuar dhe zgjatje e afatit te sekuestros per shkak te verifikimeve komplekse që janë të nevojshme te kryhen nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë.

Rezulton se për këte shtetas, nga prokurori, janë paraqitur praktika mbi zbatimin e vendimit nr xx date xxx të Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë si dhe disa nga provat shkresore te depozituara nga mbrojtja e shtetasit D.L. shoqëruar me shkresat nr xxx prot datë xxx; xxx datë xxx; xxx datë xxx si dhe xxx datë xxx duke u paraqitur dokumentacioni mbi te ardhurat e krijuara nga shtetasi D.L. e familjaret e tij per te justifikuar shumat e sekuestruara, si dhe shkresat e verifikimeve te perpiluara nga Prokuroria per Krime te Renda nga te cilat mbi “evidentimin fizikisht te nje apartamenti blere ne vleren xxx euro në xxx, duke kerkuar sekuestrimin e praktikës per menyren e pageses per blerjen e ketij apartamenti”, urdher I dates xxx, per te cilen, sipas prokurorit, ende nuk e disponon ate praktike si dhe duhet te behet balancimi i te ardhurave e kursimeve te pretenduara dhe shpenzimeve te shtetasit apo familjareve te D.L.” ndaj kerkon te zgjatet afati kohor per 3(tre) muaj i mases se sekuestros se vendosur me vendimin nr xx date xxx te Gjykates se Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Per te provuar pretendimet e tij perfaqesuesi i akuzes Prokuroi Edvin Kondili paraqiti për shqyrtim provat shkresore të praktikave lartpërmendur, sipas te cilave paraqiten aktet, **por nga ana e akuzës që kërkohet zgjatje e afatit të masës së sekuestrimit të vendosur ndaj pasurive të luajtshme të shtetasit D.L., duhet konkluduar në lidhje me sa pretenduar ne një afat te shpejtë.**

Nga Gjykata cmohet se kjo kerkese eshte e bazuar ne ligj dhe ne prova e si e tille duhet te pranohet.

Gjykata si degjoi pretendimet e prokurorit dhe shqyrtoi provat e mesiperme konkludon se, ne baze te nenit 3/1/ç te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, në kushtet kur i hetuari D.L. vijon te jete subjekt i ligjit parandalues, sipas argumentimit mbi faktin penal te kesaj gjykate ne vendimin nr 18 date 29.12.2012, Gjykata cmon të pranojë kërkesën për zgjatjen e afatit të masës së sekuestrimit.

Pra rezulton e provuar se ndaj ketyre personave eshte regjistruar procedimi penal Nr xxx nga Prokuroria per Krime te Renda Tirane dhe eshte gjykuar ne po kete gjykate, ndaj Gjykata bazuar ne nenin 5 te ligjit parandalues

vlereson se kerkesa e prokurorit dhe procedura e sekuestrimit te pasurive sipas ligjit parandalues, nuk varen nga gjendja e shkalla e procedimit penal.

Gjykata vlerëson, gjithashtu, se bazuar në ligjin 10 192 datë 03.12.2009, masat parandaluese ndaj pasurisë së të dyshuarit D.L., për të cilat kjo Gjykatë ka vendosur me vendimin nr xx datë xxx duhet te pranoje kërkimin për zgjatjen e afatit te masës së sekuestros **për shkak të verifikimeve komplekse ne referim te nenit 12 pika 3 të ligjit**, pretenduar nga prokurori ne séance, meqenese per keto shuma monetare ekziston një rrezik real dhe potencial që pasuria e luajtshme, shumat monetare lartpërmendur te tjetërsohen, apo te humbasin (neni 11/1, pikat “a” dhe “b”), e bazuar në nenet 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë” si e tille kjo kerkese duhet te pranohet.

Nga ana e prokurorise per Krime te Renda, eshte konsideruar qe te vijoje hetimi pasuror mbi llogarite bankare te ketij shtetasi per shkaqet ligjore te bazuara ne ligjin nr 10192 date 03.12.2009 e ato te argumentuara ne vendimin nr xx datë xxx nga te cilat nuk rezulton te kete rënë ndonjë shkak.

Pra sa me lart, Gjykata bindet në ekzistencën e provave dhe të indicjeve për zgjatjen e afatit te masës së sekustros mbi pasurite e luajtshme ndaj shtetasit D.L.

Ne baze te provave te marra e shqyrtuara ne seance gjyqesore, gjykata vlereson se kerkesa e akuzes per zgjatjen e afatit te masës së sekuestrimit paraprak te pasurive te evidentuara prej prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë ne pronesi te te hetuarit D.L. eshte e drejte e duhet te pranohet.

Gjykata mbi bazen e provave te shqyrtuara, vlereson se ekziston rreziku real per tjetersimin e këtyre pasurive qe janë sekuestruar me vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, qe disponohen ne emer te te hetuarit/paditurit D.L., rrethane kjo e parashikuar nga neni 12 pika 2; 3 e 5 e ligjit nr 10192 date 03.12.2009 prandaj me qellim ruajtjen e tyre eshte e domosdoshme qe per keto pasuri duhet te vijojë masa e sekuestros, bazuar ne kete ligj ne kushtet kur kerkesa gjendet e drejte dhe plotesohen kriteret e parashikuara ne kete ligj.

Ne baze te nenit 12/3 te ligjit te sipercituar masa e sekuestros mund të zgjatet në periudha tremujore, por jo me shumë se një vit nga data e mbarimit të afatit te masës së sekuestrimit, sipas pikes 2 të këtij neni (masa e sekuestros eshte e vlefshme për një periudhë gjashtëmujore duke filluar nga momenti i zbatimit te saj) e ne referim te nenit 12 pika 3 e Ligjit duke iu komunikuar palëve të interesuara mbi te drejten e ankimit ne nje gjykate të një niveli më të lartë e duke u urdheruar sekretaria gjyqesore te kryeje veprimet e njoftimit sipas nenit 130 te K.Pr.Civile, sipas urdherimit te kesaj Gjykate.

Per ekzekutimin e ketij vendimi mbeshtetur ne nenin 14 te ligjit nr 10192 date 03.12.2009 urdherohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor xxx, ndersa per

administrimin e kesaj pasurie si i ngarkuar që ka qene z. K.Xh., administrator prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane do të vijojë të ekzekutojë këtë vendim të Gjykatës.

PER KETO ARSYE:

Gjykata ne baze te neneve 148, 212 e vijues te K.Pr.Civile neni 12 e vijues te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”

V E N D O S I

Pranimin e kerkeses se Prokurorise per Krime te Renda Tirane duke urdheruar: **Zgjatjen e afatit të zbatimit të masës së sekuestrimit të pasurisë, vendosur me vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për një periudhë tremujore.**

Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor, Tirane.

Per Administrimin e kesaj pasurie te vijojë z. K.Xh., me cilësi të administratorit prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Urdherohet sekretaria Gjyqesore e kesaj Gjykate te dergoje menjehere **kopje te ketij vendimi ne Institucionet e siperme.**

Kunder vendimit lejohet te behet ankim brenda afatit te parashikuar ne K.Pr.Civile ne Gjykatën e Apelit per Krimet e Renda Tirane.

– U shpall ne Tirane sot me dt. 04.09.2013 ora 13.10.

SEKRETARE

Blerina SUKAJ

GJYQTARE

Nertina KOSOVA